

Njoftim për zhvillimin e trajnimit online për vlerësues dëmsh në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare njofton të interesuarit se në datat 28 – 29 prill 2022, do të zhvillojë aktivitetin për vlerësues dëmsh në sigurime, i cili do të njihet si pjesë e kualifikimit profesional për vitin 2022.

Aktiviteti do të zhvillohet nëpërmjet platformës elektronike TEAMS në formatin e një webinar-i, gjatë orarit 09:00-13:00 dhe do të jetë pa pagesë për pjesëmarrësit.

Për regjistrimin në këtë aktivitet, të interesuarit duhet të plotësojnë formularin e regjistrimit, në bazë të cilit do të dërgohen të dhënat e regjistrimit në webinar. Afati i fundit për regjistrim do të jetë data 26/04/2022, ora 16:30.

Formularin e Regjistrimit mund ta gjeni në linkun: <https://crm.amf.gov.al/regjistrim>

Të dhënat dhe linku i webinar-it do t'u dërgohet vetëm personave të cilët do të kenë kryer regjistrimin.

Për t'u njohur me programin e këtij aktiviteti kliko [këtu](#).